



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.86

2004

26 nëntor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Urdhër i ILDKP
nr.16, datë 25.11.2004

Për një ndryshim në urdhrin nr.1, datë 13.1.2004 të Inspektorit
të Përgjithshëm “Për miratimin e modelit të deklaratës së
pasurisë dhe autorizimit përkatës”

6285

URDHËR
Nr.16, datë 25.11.2004

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.1, DATË 13.1.2004 TË INSPEKTORIT TË
PËRGJITHSHËM “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË DEKLARATËS SË PASURISË
DHE AUTORIZIMIT PËRKATËS”**

Në bazë të ligjit nr.9049, datë 10.4.2004 “Për deklarimin dhe kontrollin pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr.1, datë 13.1.2004 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e modelit të deklaratës së pasurisë dhe autorizimit përkatës”, modeli i deklaratës së pasurisë dhe autorizimi përkatës për subjektet që mbartin detyrimin për deklarim në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 bashkëlidhur, të ndryshohet dhe të zëvendësohet me modelin e deklaratës së pasurisë dhe autorizimit përkatës bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Fatmira Laska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

Adresa: Rr. Reshit Çollaku” Tel: 04 234 918, Fax: 04 228 516 E-mail: Info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi	
Viti i deklarimit	

DEKLARIM
I PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA
NËPUNËSVE PUBLIKË
(Ligji nr.9049, datë 10.4.2003)

• **Kush mbart detyrimin për deklarim:**

Të gjitha subjektet (personat) që mbajnë funksionet e renditura në nenin 3 të ligjit.

• **Llojet e deklarimit, afati i plotësimit të deklaratës dhe objekti i deklarimit:**

Sipas llojit të deklarimit, vendosni në kuti shenjë “X”.

☐ **Deklarimi i parë, apo para fillimit të punës**, në një nga funksionet që të detyron të deklarojë pasurinë, duhet plotësuar brenda 30 ditëve të fillimit të detyrës.

Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të gjitha pasuritë e akumuluar ndërkohë, detyrimet financiare, burimet dhe origjina e pasurisë së vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare (lexo nenin 6, 9 dhe 21 të ligjit).

☐ **Deklarimi vjetor** dorëzohet brenda datës 31 mars të çdo viti. Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen vetëm ndryshimet në gjendjen e pasurive për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, burimet e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare të vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve në moshë madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare (lexo nenin 4 të ligjit).

☐ **Deklarimi pas largimit nga funksioni** duhet plotësuar deri 2 vjet (2 deklarime vjetore) pas largimit nga funksioni dhe deri në 4 vjet (4 deklarime vjetore) për disa lloj funksionesh (lexo nenin 8 të ligjit). Llogaritja e këtij deklarimi është 31 dhjetori i vitit paraardhës.

☐ **Deklarimi me kërkesë** bëhet me urdhr të Inspektorit të Përgjithshëm ndaj personave juridikë e fizikë të lidhur me subjektin që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë (lexo nenin 7 të ligjit).

• **Pyetje, ndihmë dhe ku do të merret e dorëzohet deklarata:**

Të gjitha subjektet janë të detyruara të marrin e të dorëzojnë dokumentin deklarativ pranë Inspektoratit të Ulët të ngritur në institucionet ku kryejnë funksionin apo ku kanë punuar deri pas largimit nga funksioni, sipas rastit mund edhe të kërkohet ndihmë për plotësimin e saj po në Inspektoratin e Ulët (lexo nenin 18, 19, 23 të ligjit).

Në qoftë se ju keni pyetje të tjera, kontaktoni me ILDKP-në në numrin pa pagesë **0800 9999**, si dhe në numrin **234 918**.

Për më tepër informacion, mund të drejtoheni në: www.hidaa.gov.al.

• **Masat administrative:** Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit, publikimin, ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal (lexo nenin 5 të ligjit).

Kur deklarata dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti gjobitet me 25000 lekë. Në qoftë se deklarata nuk dorëzohet edhe 15 ditë pas komunikimit të gjobës, njoftohen organet përkatëse dhe gjoba dyfishohet (lexo nenin 40 të ligjit).

Vërtetohet se deklarimet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

TË DHËNAT PERSONALE

Plotëso me germa të mëdha

Emri	Atësia	Mbiemri
Funksioni	Institucioni	
Adresa e institucionit	Vendi	
Data e emërimit në detyrë	Data e largimit nga detyra	Data e dorëzimit të deklaratës

Sipas nenit 34 të ligjit, të dhënat e deklaratës publikohen, përveç të dhënave të faqes 7 dhe 8.

Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

PËRBËRJA FAMILJARE

Të plotësohet përbërja familjare sipas regjistrit të zyrës së gjendjes civile nr.

Njësia administrative nr.

Bashkia/komuna

dhe adresa e plotë ku banoni:

Sipas nenit 1 të ligjit nr.9049 datë10.4.2003, kërkohet deklarimi dhe kontrolli edhe për familjarët e të zgjedhurve dhe të nëpunësve publikë.

Tabelat të plotësohen me germa të mëdha

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Lidhja me deklaruesin	Gjendja civile
				DEKLARUESI	

Pjesëtarë të familjes me pasuri të regjistruar në emër të vet

Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëngjitet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim (lexo nenin 22 të ligjit).

Nëse një ose disa pjesëtarë të familjes për shkak të funksionit që kryejnë mbartin detyrimin për deklarim, deklaratat do të dorëzohen së bashku në Inspektoratin e Ulët të institucionit, ku pjesëtari i familjes kryen funksionin më të lartë.

Emri	Atësia	Mbiemri	Lidhja me deklaruesin	Lloji i pasurisë

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Në këtë seksion do të pasqyroni pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme (në emër të deklaruesit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve madhorë), të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri më datë 31 dhjetor të vitit paraardhës.

Çfarë përfshihet në pasuritë e paluajtshme:

Toka, burime, rrjedhje uji, uzina, fabrika, dyqane, shtëpi e apartamente banimi, ndërtime të ndryshme, si hoteleri, pikë karburanti, magazina, pishina etj., mbi të cilat ju ushtroni një të drejtë reale, pavarësisht nëse janë të regjistruara ose jo në ZRP të Paluajtshme (Në kolonën përkatëse do të përshkruani me hollësi pronën, si p.sh. sasinë në natyrë, sipërfaqen në m², vlerën e pronës, vitin e ndërtimit etj.).

Çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme:

Të gjitha mjetet motorike për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror, siç janë: zyrat noteriale, tatimore, drejtoritë e shfrytëzimit të automjeteve, kapiteneria e porteve, të regjistrit hekurudhor, ajror, gjykata, banka etj., pasuritë e tjera të luajtshme, si sende që kanë një vlerë të veçantë mbi 5000 dollarë amerikanë (ose ekuivalenti në çdo monedhë tjetër), aksione, letra me vlerë, gjendje *cash*, pjesë kapitali në zotërim, likuiditete në bankë, duke përfshirë këtu edhe depozitat për fëmijët e mitur apo personat që keni në ngarkim etj. (lexo nenin 4 të ligjit).

Kujtesë: Në deklarimin vjetor do të pasqyroni vetëm ndryshimet e ndodhura në pasurinë tuaj gjatë një viti.

Të dhënat për pasuritë që do të deklaroni, si p.sh. numrat e regjistrave të ZRPP-së, numra të ndryshëm të regjistrave publikë, emra të personave të cilëve u keni dhënë hua në lekë apo në valutë të huaj etj. që ju e çmoni se janë konfidenciale, do t'i shënoni në faqen 7, e cila nuk do të publikohet.

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie (Lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit	Pjesa që zotëron (në %, sasi apo vlerë)	Data, viti i krijimit të pasurisë
1			
2			
3			
4			
5			

Deklarimi është i pavarësishëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Nëse kjo tabelë është e pamjaftueshme mund të vazhdoni në faqen 4.

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie (Lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit	Pjesa që zotëron (në %, sasi apo vlerë)	Data, viti i krijimit të pasurisë
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Deklarimi i detyrimeve financiare si kërkesë e nenit 4 të ligjit do të ndihmojë në argumentimin e drejtë të pasurisë së vënë ndër vite apo gjatë një viti.

Çfarë detyrimesh do të përfshihen:

Në tabelën e mëposhtme duhet të renditen të gjitha detyrimet financiare (kredi, hua, borxh etj.) që keni pasur ose keni ju, bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë (që keni në përbërjen familjare) dhe që ju kanë shërbyer për të krijuar pasuri të ndryshme të paluajtshme apo të luajtshme.

Detyrimet do të shprehen në lekë apo në valutë sikurse është bërë aktmarrëveshja, të tregohet shkaku i marrjes, shuma e marrë, kohëzgjatja dhe personi huadhënës sipas tabelës së mëposhtme.

Plotësoni dy kolonat e fundit në lekë
apo në valutë (me shifra dhe me shkrim)

Përshkrimi i hollësishëm i detyrimit financiar (shuma e marrë, kohëzgjatja, interesi bazë, etj.)	Numri dhe data e kontratës (nëse ka)	Ndaj kujt keni detyrime financiare	Shuma e detyrimit financiar (+ interesi) e shlyer deri më 31 dhjetor	Shuma e detyrimit financiar (+ interesi) e pashlyer, deri më 31 dhjetor
1				
2				
3				
4				
5				

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

TË ARDHURAT

Çfarë përfshihen në të ardhurat:

Të ardhurat vjetore nga paga, shpërblime, pjesëmarrja në borde, komisione apo çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura, shitja apo qiraja e përfutur nga objekte të ndryshme, të luajtshme apo të paluajtshme, të ardhurat që përfitohen nga licencat dhe patentat, të ardhurat individuale që përfitohen nga qenia ortak apo pjesëmarrës në kapital në shoqëritë fitimprurëse (shuma e dividendit apo e fitimit të tërhequr nga biznesi ku subjekti është pjesëmarrës) ose të ardhurat nga çdolloj përfshirjeje në organizatat jofitimprurëse, përqindjet e përfutura nga depozitat bankare apo nga huadhëniet e realizuara me personat juridikë e fizikë, si dhe çdolloj e ardhure tjetër.

Kujtesë:

Në deklarimin e parë apo para fillimit të detyrës, subjekti duhet të deklarojë edhe të ardhurat e realizuara në përgjithësi ndër vite; personale, të bashkëshortit/es dhe të fëmijëve që ka në përbërjen familjare.

Në deklarimin vjetor subjekti duhet të deklarojë të gjitha të ardhurat e siguruar deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, si ato personale, të bashkëshortit/es dhe të fëmijëve që ka në përbërje familjare.

Përshkrimi më vete i çdo lloji të ardhure për secilin pjesëtar të familjes së subjektit dhe mënyra e sigurimit të këtyre të ardhurave	Shuma faktike e të ardhurave vjetore që kanë qenë në disponim të personit e familjes në lekë apo në valutë (e ardhura neto, (me shifra dhe me shkrim))	Vendi i punës, emërtimi i aktivitetit nga i cili janë siguruar të ardhurat, adresat përkatëse
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyrojnë identitetin e firmën.

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

INFORMACION KONFIDENCIAL

Të dhëna mbi regjistrimin e pasurive

Në tabelën e mëposhtme pasqyroni të dhënat që lidhen me numrat e regjistrimit të pronës në regjistrat publikë (të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të luajtshme, zyrave noteriale, gjykatë etj.), si dhe numrat e llogarive apo të dhëna të tjera që keni ju nga marrëdhëniet me institucionet financiare (si banka, shoqëri sigurimesh etj.) brenda dhe jashtë vendit.

Emërtimi i pasurisë së deklaruar	Nr. i regjistrimit apo llogarisë	Vendi i regjistrimit të pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		

Shënime

N.q.s. çmohet e arsyeshme nga ju për të dhënë sqarime të mëtejshme lidhur me pasuritë tuaja, si për origjinën e tyre, burimin e të ardhurave etj., mund t'i përshkruani të dhënat edhe në fletë të tjera të veçanta dhe t'ia bashkëngjitni deklaratës së bashku me dokumentet që dispononi (lexo nenin 24 të ligjit).

Personat e lidhur me subjektin që mbart detyrimin për deklarim

N.q.s. jeni bashkëpronarë me persona juridikë e fizikë, (pa përfshirë këtu bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë), plotësoni tabelën e mëposhtme.

Emri, mbiemri i personit fizik ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklartuesin	Lloji i pasurisë dhe adresa e plotë e saj

Kjo faqe nuk publikohet.

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE I KONTROLLIT TË PASURIVE

AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9049, data 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", **Unë**

si subjekt i detyrimit për deklarim të pasurisë nën përgjegjësinë time, autorizoj Inspektoratin e Lartë/ të Ulët ose çdo person tjetër të autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, të ushtrojë çdolloj kontrolli mbi vërtetësinë, saktësinë dhe burimet e pasurive personale dhe familjare, që ndodhen brenda dhe jashtë Shqipërisë, në të gjitha subjektet, publike dhe private.

Emri, mbiemri, nënshkrimi

Dorëzuar më datë

Adresa e kontaktit

Për çdo ndryshim të mundshëm, njoftoni pranë Inspektoratit të Lartë/ Ulët.

Telefon privat

Celular privat

E-mail

Adresa private

Telefon zyre

Celular zyre

Faks zyre

Kujtesë:

Deklarata dhe të gjitha dokumentet që e shoqërojnë atë janë dokumente zyrtare.

Ekzistojnë sanksione ligjore, administrative dhe penale në rast të fshehjes ose të deklarimit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe të nëpunësve publikë (lexo nenin 5, 28, 31, 32 dhe 38 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe nenin 257/a të Kodit Penal).

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 26.11.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 50 lekë